



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 270 / prot.

Tiranë, më 13 . 10 . 2025

**NJOFTIM PËR POZICIONIN VAKANT "INSPEKTOR" NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT**

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8 /2023 "*Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror*", Urdhrit të Kryeministrit nr.117 datë 26.08.2025 "*Per disa ndryshime në urdhrin nr.222, datë 14.12.2023, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror"*" i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit shpall në faqen zyrtare të DPP njoftimin për personat e interesuar për pozicionin:

1 (një) Inspektor, Drejtoria e Inspektimit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit

- **Kategoria e pagës:** Klasa III-1 (sipas VKM nr. 325, datë 31.05.2023, i ndryshuar)
- **Lloji i punës:** Punë me kohë të plotë (8 orë në ditë, me afat të caktuar)

Detyrat kryesore:

- a) realizimin e detyrave të ngarkuara nga kuadri rregullator në fuqi ose nga eprorët përkatës, brenda afatit dhe raportimit mbi to;
- b) kujdeset për saktësinë e të dhënave gjatë shqyrtimit fillestar, verifikimit, hetimit disiplinor, inspektimit, si dhe për përfundimin e detyrave në afatin e përcaktuar;
- c) ligjshmërinë e veprimtarisë së kryer;
- d) evidentimin e analizës së nevojave për trajnim të përmbarruesve gjyqësorë;
- e) kryen çdo detyrë tjetër që ngarkohet nga eprorët.

I. Kushtet që duhet të plotësojnë kandidati:

1. Të jenë shtetas shqiptar;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojnë gjuhën shqipe në të folur dhe të shkruar;
4. Të jenë në kushtet shëndetësore që lejojnë kryerjen e detyrave përkatëse;
5. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë;
6. Niveli i Diplomës- Master i Shkencave në fushën e Drejtësisë ose i barasvlefshëm me të;
7. Të kenë aftësi të mira komunikuese;
8. Të respektojnë etikën dhe komunikimin me qytetarët që drejtohen pranë institucionit;

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

1. Kërkesë për aplikim për pozicionin;
2. Diplomë e arsimit
3. Librezë pune (të gjitha fletët që vërtetojnë eksperiencën e punës);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
7. Curricilum Vitae
8. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit, që nuk ka çështje penale në ngarkim
9. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit, që nuk ka çështje penale në ngarkim
10. Vërtetim për detyrimet permbarimore

Dokumentat duhet të dorëzohen dorazi ose nëpërmjet postës zyrtare në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit me adresë sheshi. "Mustafa Qemal Atatürk", Njësia Administrative nr. 7, kryqëzimi 21 dhjetorit, Tiranë, deri në datën 20.10.2025.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Qiria

